

Važna napomena: Prevod ovog propisa, odnosno akta sa srpskog jezika na albanski jezik, omogućila je Misija Organizacije za evropsku bezbednost i saradnju u Republici Srbiji (dalje: Misija OEBS u Srbiji) sa ciljem da se pripadnicima i pripadnicama nacionalne manjine, čiji je jezik u službenoj upotrebi u Republici Srbiji, omogući da se na svom jeziku i pismu obaveste i upoznaju sa sadržinom teksta propisa, odnosno akta koji je predmet ovog prevoda.

Misija OEBS u Srbiji posebno napominje da je isključivo i jedino pravno-relevantan i merodavan tekst propisa, odnosno akta (koji je predmet prevoda u ovom dokumentu) koji je objavljen na srpskom jeziku, u skladu sa i shodno propisu koji uređuje objavljivanje zakona i drugih propisa i akata u Republici Srbiji.

Za potrebe prevoda ovog propisa Misija OEBS u Srbiji angažovala je kompaniju Eurotranslate d.o.o. koja je u celosti, i u svemu prema pravilima struke, odgovorna i garantuje za jasnoću, preciznost, istinitost i tačnost izvršenog prevoda na albanski jezik. Misija OEBS u Srbiji ni po jednom osnovu nije odgovorna i ne garantuje za jasnoću, preciznost, istinitost i tačnost izvršenog prevoda.

Shënim i rëndësishëm: Përkthimin e kësaj dispozite, respektivisht akti nga gjuha serbe në gjuhën shqipe, e ka mundësuar Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian në Republikën e Serbisë (në tekstin e mëtejshëm: Misioni i OSBE-së në Serbi) me qëllim që pjesëtarëve dhe pjesëtareve të pakicës kombëtare, gjuha e të cilëve është në përdorimi zyrtar në Republikën e Serbisë, t'ua mundësojë që në gjuhën dhe shkrimin e tyre të informohen dhe të njihen me përmbajtjen e tekstit apo dokumentit, i cili është objekt i këtij përkthimi.

Misioni i OSBE-së në Serbi, në veçanti tërheq vërejtjen se teksti i rregullores, është ekskluzivisht teksti i vetëm ligjor-relevant dhe kompetent, respektivisht i aktit (i cili është objekt i përkthimit në këtë dokument), i cili është botuar në gjuhën serbe, në përputhje me dhe në pajtim me dispozitën që përcakton shpalljen e ligjit dhe dispozitave dhe akteve tjera në Republikën e Serbisë.

Për nevojat e përkthimit të kësaj dispozite, Misioni i OSBE-së në Serbi ka angazhuar kompaninë Eurocontract sh.p.k. e cila në tërësi, dhe sipas të gjitha rregullave të profesionit, është përgjegjëse për qartësinë, precizitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e përkthimit të bërë në gjuhën shqipe. Misioni i OSBE-së në Serbi për asnjë arsye nuk është përgjegjës dhe nuk garanton për qartësinë, precizitetin, vërtetësinë dhe saktësinë e përkthimit të bërë.

Në bazë të nenit 62 paragrafi 1, pika 4 e nenit 66 , paragrafi 3 i Ligjit për këshillat kombëtare të pakicave kombëtare ("Fletorja zyrtare e RS", nr. 72/09, 20/14 – vendimi i GJK dhe 55/14), Komisioni Republikan i Zgjedhjeve, në seancën e mbajtur më 8 shtator të vitit 2014, i ka miratuar

R R E G U L L A T

PËR PUNËN E KËSHILLAVE TË ZGJEDHJEVE PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE TË DREJTPËRDREJTA PËR ANËTARË TË KËSHILLAVE KOMBËTARE TË PAKICAVE KOMBËTARE

I. DISPOZITA HYRËSE

Neni 1

Me këto rregulla më hollësisht rregullohet puna e këshillave të zgjedhjeve, të formuara në pajtim me Udhëzimin për zbatimin e zgjedhjeve të drejtpërdrejta për anëtarë të këshillave kombëtare të pakicave kombëtare ("Fletorja zyrtare e RS", numër 89/14), në zbatimin e votimit në zgjedhjet e drejtpërdrejta për anëtarë të këshillave kombëtare të pakicave kombëtare (në tekstin e mëtejme: zgjedhjet).

Neni 2

(1) Këshilli i zgjedhjeve drejtpërsëdrejti e zbaton votimin në qendër të votimit, e siguron rregullsinë dhe fshehtësinë e votimit, i konstaton rezultatet e votimit në qendër të votimit dhe i kryen punët e tjera të caktuara me ligj dhe me këto rregulla.

(2) Këshilli i zgjedhjeve vendos me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(3) Puna e Këshillit të zgjedhjeve është publike.

(4) Derisa qendra e votimit është e hapur dhe derisa zgjat votimi, të gjithë anëtarët e këshillit të zgjedhjeve ose zëvendësit e tyre duhet të jenë në qendër të votimit ose me radhë ta zëvendësojnë njëri tjetrin.

(5) Anëtarët e këshillit të zgjedhjeve të cilët janë të caktuar që të përdorin sprajin me bojë shkrimi të padukshme, e të cilët votojnë në qendër tjetër të votimit, u mundësohet që në qendrën e tyre të votimit të votojnë me aktvendim për emërim për anëtar të këshillit të zgjedhjeve.

II. PRANIMI I MATERIALIT TË ZGJEDHJEVE

Neni 3

(1) Organet e punës së Komisionit Republikan të Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejme: organet e punës) kanë për detyrë që materialin zgjedhor për zbatimin e votimit në qendër të votimit t'ua dorëzojnë këshillave të zgjedhjeve jo më vonë se 48 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

(2) Lista e materialit të zgjedhjeve e cila i dorëzohet secilit këshilli të zgjedhjeve për zbatimin e zgjedhjeve gjendet në procesverbalin për marrjen në dorëzim të materialit zgjedhor para votimit midis organit të punës dhe këshillit të zgjedhjeve në formularin të cilin e përcakton Komisioni Republikan i Zgjedhjeve.

III. PËRGATITJA PËR FILLIMIN E VOTIMIT

Neni 4

(1) Në ditën e zgjedhjeve këshilli i zgjedhjeve takohet në orën 6,00 në qendër të votimit, për t'i bërë përgatitjet për fillimin e votimit.

(2) Anëtarët e këshillit të zgjedhjeve e rregullojnë qendrën e votimit ashtu që dukshëm e theksojnë numrin dhe emërtimin e qendrës së votimit, kopjen nga Aktvendimi për caktimin e qendrave të votimit, aktvendimin për formimin e këshillit të zgjedhjeve dhe flamurin e popullit të Republikës së Serbisë, si edhe listat shumëemërore për zgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të secilit këshilli kombëtar i cili zgjedhet në qendër të votimit.

(3) Anëtarët e këshillit të zgjedhjeve e përgatisin fillimin e votimit sipas kësaj radhe: e përcaktojnë a është materiali për votim i rregullt dhe i plotë, e rregullojnë qendrën e votimit dhe merren vesh për mënyrën e punës dhe ndarjen e obligimeve me rastin e zbatimit të votimit.

a) Përcaktimi i plotësisë dhe i rregullsisë së materialit për zgjedhje

Neni 5

(1) Materialin e pranuar të zgjedhjeve këshilli i zgjedhjeve e krahason me gjendjen nga Procesverbali për marrjen në dorëzim të materialit zgjedhor para votimit midis organit punues dhe këshillit të zgjedhjeve dhe kështu e përcakton a është materiali të cilin e ka marrë i plotë dhe në rregull.

(2) Nëse mungon ndonjë gjë në material zgjedhor, këshilli i zgjedhjeve e konstaton këtë në Peroceverbalin për punë të këshillit të zgjedhjeve në zbatimin e votimit dhe në përcaktimin e rezultateve të votimit në zgjedhje për anëtarë të këshillit kombëtar të nje pakice të caktuar kombëtare (në tekstin e mëtejshëm: procesverbali për punën e këshillit të zgjedhjeve) dhe për këtë menjëherë e njohton organin punues.

b) Rregullimi i qendrës së votimit

Neni 6

Këshilli i zgjedhjeve e rregullon ambientin për votim kështu që nga hyrja deri te kutia e votimit, vendet për kryerjen e veprimeve zgjedhore vendosen sipas kësaj radhitjeje:

- 1) vendi në të cilin anëtari i këshillit të zgjedhjeve e përdor llambën UV;
- 2) vendi në të cilin konstatohet identiteti i zgjedhësit;
- 3) vendi në të cilin gjendet kopja në listën e veçantë e votimit në qendër të votimit (në tekstin e mëtejshëm: kopja në listën e zgjedhësve) për secilin këshill kombëtar që zgjedhet në qendër të votimit dhe kopjet e veçanta nga lista e zgjedhësve për votim të zgjedhësve të cilët janë në shërbim ushtarak, stërvitje ushtarake ose në shkollim në njësitë ose institucionet e Ushtrisë së Serbisë;
- 4) vendi në të cilin dorëzohet fleta e votimit;
- 5) vendi në të cilin anëtari i këshillit të zgjedhjeve e përdor sprajin për shënimin/timbrosjen e gishtit të zgjedhësit;
- 6) ndarëset për votim, të cilat duhet të jenë ashtu të vendosura që ta sigurojnë fshetësinë e votimit;
- 7) kutia e votimit.

Neni 7

(1) Këshilli i zgjedhjeve e verifikon në qendër të votimit dhe në 50 metra larg nga qendra e votimit a janë theksuar simbolet e propozuesve të listave të kandidatëve dhe materiali tjetër propagandistik i zgjedhjeve.

(2) Nëse në qendër të votimit dhe në 50 metra nga qendra e votimit është theksuar material propagandues i zgjedhjeve, këshilli i zgjedhjeve e largon vetë ose për nevojën që ai të mënjanohet e njohton shërbimin komunal kompetent.

c) Marrëveshja për ndarjen e punës

Neni 8

Anëtarët e këshillit të zgjedhjeve merren vesh për ndarjen e punës, me ç'rast më e rëndësishme është që të konstatohet cilët anëtarë përkatësisht zëvendës të anëtarëve, do të ngarkohen për zbatimin e këtyre veprimeve:

1) përdorimi i llambës UV;

2) konstatimi i identitetit të zgjedhësit;

3) përdorimi i kopjeve në listën e zgjedhësve për secilin këshill kombëtar i cili zgjedhet në qendër të votimit dhe në kopjet e veçanta në listën e zgjedhësve për votim të zgjedhësve të cilët janë në shërbim ushtarak, stërvitje ushtarake ose në shkollim në njësi ose institucionet e Ushtrisë së Serbisë;

4) ruajtja dhe dorëzimi i fletëve të votimit;

5) përdorimi i sprajit për shënimin e gishtit të zgjedhësit;

6) udhëzimi i zgjedhësve si të votohet.

IV. HAPJA E QENDRËS SË VOTIMIT

Neni 9

(1) Pasiqë i kryen përgatitjet për zbatimin e votimit, këshilli i zgjedhjeve konstaton se votimi mund të fillojë, dhe këtë e konstaton në procesverbalin për punë të këshillit të zgjedhjeve.

(2) Qendra e votimit hapet në orën 7,00 në ditën e mbajtjes së zgjedhjeve.

Verifikimi i rregullsisë së kutisë së votimit

Neni 10

(1) Në qendër të votimit gjendet një kuti e votimit, e cila përdoret për votim në zgjedhje për anëtarë të të gjitha këshillave të votimit të cilat zgjedhen në qendër të votimit.

(2) Verifikimi i rregullsisë së kutisë së votimit bëhet në prani të zgjedhësit të parë i cili vjen në qendër të votimit, kurse rezultati i verifikimit shënohet në listë të kontrollit për verifikim të rregullsisë së kutisë së votimit.

(3) Procedura e verifikimit bëhet sipas kësaj radhitjeje:

1) kur në qendër të votimit arrin zgjedhësi i parë i cili nuk është anëtar i këshillit të zgjedhjeve, këshilli i zgjedhjeve do të bëjë verifikimin me llambë UV, do të konstatojë identitetin e tij dhe do të konstatojë a është regjistruar në ndonjë nga kopjet në listën e zgjedhësve;

2) në prani të këtij zgjedhësi këshilli i zgjedhjeve e verifikon a është kutia e votimit e rregullt dhe a është e zbrazët;

3) plotësohet lista e kontrollit në të cilën shënohet në cilin kopje të listës së zgjedhësve dhe nën cilin numër rendor është i regjistruar zgjedhësi dhe e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e këshillit të zgjedhjeve dhe zgjedhësi i cili i pari arrin në qendër të votimit;

4) në prani të zgjedhësit të parë, lista e kontrollit hidhet në kuti të votimit, e cila pas kësaj mbyllet dhe vulozet me lidhëse të kuqe dhe me dyllë të vulosjes;

5) të gjitha veprimet e kryera konstatohen në të gjitha procesverbalet për punën e këshillit të zgjedhjeve për secilin këshill kombëtar i cili zgjedhet në qendër të votimit.

Neni 11

Verifikimi i rregullsisë së kutisë së votimit nuk mund të bëhet në prani të zgjedhësit për të cilin, pas verifikimit me llambë UV, është konstatuar se ka votuar në qendër tjetër të votimit, i cili nuk ka dokument

të vlefshëm publik për verifikimin e identitetit, ose i cili nuk është regjistruar në asnjë kopje në listë të zgjedhësve.

V. VOTIMI NË QENDËR TË VOTIMIT

Neni 12

Kur zgjedhësi arrin në qendër të votimit, këshilli i zgjedhjeve ka për detyrë të ndërmarrë këto veprime: e verifikon a ka votuar zgjedhësi në ndonjë qendër tjetër të votimit, e vërteton identitetin e votuesit, e verifikon a është i regjistruar zgjedhësi në ndonjë nga kopjet në listat e zgjedhësve, dorëzimin e fletës së votimit, shënimin/timbrosjen e zgjedhësit me spraj dhe e udhëzon zgjedhësin për mënyrën e votimit.

a) E vërteton a ka votuar zgjedhësi në ndonjë qendër tjetër të votimit

Neni 13

(1) Kur hyn në qendër të votimit, zgjedhësi i afrohet anëtarit të këshillit të zgjedhjeve me llambë UV, i cili e verifikon a është shënuar gishti tregues i dorës së djathtë të votuesit me bojë shkrimi të padukshme.

(2) Në rastin kur zgjedhësi nuk e ka gishtin tregues të dorës së djathtë, e verifikon a i ka të shënuar me bojë shkrimi gishtat e tjerë të dorës së djathtë, e nëse zgjedhësi nuk e ka dorën e djathtë, e verifikon a i ka të shënuar me bojë shkrimi gishtat e dorës së majtë.

(3) Nëse pas verifikimit me llambë UV konstaton se zgjedhësi ka votuar në qendër tjetër të votimit, ai nuk mund të votojë dhe ka për detyrë që menjëherë të largohet nga qendra e votimit.

b) Konstatimi i identitetit të zgjedhësit

Neni 14

(1) Pasiqë vërtetohet se zgjedhësi nuk ka votuar, ai i afrohet anëtarit tjetër të këshillit të zgjedhjeve, ia thotë emrin dhe mbiemrin e vet, ia dorëzon njohtimin për ditën dhe kohën e mbajtjes së zgjedhjeve, nëse e ka, dhe e dëshmon identitetin e vet.

(2) Zgjedhësi i cili është i regjistruar në kopjen në Listën e zgjedhësve mund të votojë edhe pa njohtim për ditën dhe kohën e mbajtjes së zgjedhjeve.

(3) Zgjedhësi nuk mundet të votojë nëse nuk paraqet dëshmi për identitetin e vet.

(4) Identitetin e vet zgjedhësi e dëshmon me letërnjohtim të vlefshëm.

(5) Letërnjohtim i vlefshëm është:

1) letërnjohtimi në formularin e vjetër të lëshuar para 27 janarit të vitit 2007, të cilës nuk i ka skaduar afati i vlefshmërisë i theksuar në letërnjohtim;

2) letërnjohtimi në formularin e vjetër i lëshuar pas 27 janarit të vitit 2007, në të cilin si afat i vlefshmërisë është regjistruar data "27 korrik i vitit 2011";

3) letërnjohtimi i lëshuar në formular të ri, me çip - kontakt mikrokontrollues, të cilit nuk i ka skaduar afati i vlefshmërisë i theksuar në letërnjohtim;

4) letërnjohtimi i lëshuar në formular të ri, pa çip - kontakt mikrokontrollues, të cilit nuk i ka skaduar afati i vlefshmërisë i theksuar në letërnjohtim.

(6) Përveç me letërnjohtim, identitetin e vet zgjedhësi mund ta dëshmojë edhe me dokument të vlefshëm të udhëtimit (pasaportë), si edhe me patentë shoferi e cila e ka numrin unik personal të qytetarëve.

(7) Zgjedhësi i cili është regjistruar në kopje të veçantë në listën e zgjedhësve për votim të zgjedhësve në kryerjen e shërbimit ushtarak, stërvitje ushtarake ose në shkollim në njësi ose institucionet të Ushtrisë së Serbisë, identitetin e vet mund ta dëshmojë edhe me librezë ushtarake e cila e përmban fotografinë e zgjedhësit dhe numrin unik personal të qytetarëve.

(8) Zgjedhësi i cili voton në qendër të votimit brenda Institucionit për ekzekutimin e sanksioneve të institucionit, identitetin e vet mund ta dëshmojë edhe me dokument përkatës të cilin ia lëshon Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve penale.

c) Konstatimi se a është regjistruar zgjedhësi në kopjen në listën e zgjedhësve dhe a i është dorëzuar fleta e votimit

Neni 15

Kur të konsatohet identiteti i tij, zgjedhësi tregon cilës pakicë kombëtare i takon dhe i afrohet anëtarit të këshillit të zgjedhjeve i cili është i ngarkuar për përdorimin e kopjes në Listën e zgjedhësve për këtë

pakicë kombëtare, përkatësisht anëtarit të këshillit të zgjedhjeve i cili e përdor kopjen e veçantë përkatëse në listën e zgjedhësve për votimin e zgjedhësve të cilët janë në shërbim ushtarak, stërvitje ushtarake ose në shkollim në njësi ose institucione të Ushtrisë së Serbisë, i cili e gjen zgjedhësin dhe e rrumbullakëson numrin rendor para emrit të zgjedhësit, pas së cilës zgjedhësi nënshkruhet në vend përkatës në kopjen në listën e zgjedhësve. Pasiqë zgjedhësi nënshkruhet, anëtari i këshillit të zgjedhjeve ia dorëzon fletën e votimit.

Neni 16

(1) Këshilli i zgjedhjeve nuk mund të bëjë kurrfarë shkrimesh shtesë ose ndryshime të tjera në kopjen në listën e zgjedhësve.

(2) Këshilli i zgjedhjeve nuk do të lejojë të votojë personin i cili nuk është i regjistruar në asnjë kopje në listën e zgjedhësve.

Neni 17

(1) Zgjedhësi mund të votojë vetëm një herë.

(2) Asnjë person nuk mund të marrë më shumë se një fletë të votimit as nuk lejohet që një person të votojë në vend të personit tjetër.

d) Përdorimi i sprajit

Neni 18

(1) Vetëm kur i dorëzohet fleta e votimit, zgjedhësi i afrohet anëtarit të këshillit të zgjedhjeve i cili me spraj të veçantë ia spërkat gishtin tregues të dorës së djathtë nën shtratin e thoit si shenjë që ka votuar.

(2) Zgjedhësit i cili nuk e ka gishtin tregues të dorës së djathtë i spërkatet gishti tjetër nga ana e djathtë dhe më në fund gishtin e madh të kësaj dore nën shtratin e thoit.

(3) Zgjedhësit i cili nuk e ka shuplakën e dorës së djathtë, i spërkatet gishti tregues i dorës së majtë, përkatësisht gishti tjetër nga ana e majtë dhe më në fund gishti i madh i kësaj dore, nën shtratin e thoit.

(4) Nëse nuk ekziston mundësia që gishtërinjtë të shënohen kështu, shënimi nuk bëhet.

e) Plotësimi i fletëve të votimit

Neni 19

(1) Zgjedhësi e plotëson fletën e votimit pas ndarëses për votim pasi që anëtari i këshillit të zgjedhjeve e mëson se si duhet të votojë.

(2) Anëtari i këshillit të zgjedhjeve veçanërisht do ta paralajmërojë zgjedhësin:

1) se mund të votojë vetëm për një listë të kandidatëve, duke e rrumbullakësuar numrin rendor para emërimit të listës së kandidatëve;

2) se votimi është i fshehtë dhe që bëhet pas ndarëses për votim;

3) se votimi është i lirë dhe që askush nuk ka të drejtë ta pengojë ose detyrojë zgjedhësin të votojë, të kërkojë përgjegjësi prej tij për shkak se nuk ka votuar ose të kërkojë nga zgjedhësi të deklarohet pse dhe për kë ka votuar.

(3) Pasi që e plotëson fletën e votimit, zgjedhësi vetë e palos fletën e votimit ashtu që të mos shihet si ka votuar dhe e hedh në kuti të votimit, e pastaj largohet nga qendra e votimit.

Neni 20

(1) Këshilli i zgjedhjeve ka për detyrë të kujdeset për sigurimin e fshehtësisë së votimit.

(2) Këshilli i zgjedhjeve ka për detyrë të organizojë votimin ashtu që askush nuk mund të shohë si e plotëson zgjedhësi fletën e votimit.

(3) Në ambientet në të cilat votohet mund të jenë të pranishëm vetëm aq zgjedhës sa vende ka në të cilat është siguruar fshehtësia e votimit.

VI. RREGULLAT E VEÇANTA TË VOTIMIT PËR PERSONA ME INVALIDITET DHE PERSONA TË PENGUAR

a) Personi i cili nuk është në gjendje ta plotësojë fletën e votimit

Neni 21

(1) Zgjedhësi i cili nuk mund ta plotësojë vetë fletën e votimit (personi i verbër, invalid ose personi që nuk di shkrim-lexim) ka të drejtë që në qendër të votimit ta marrë me vete ndihmësin i cili në vend të tij do ta plotësojë fletën e votimit ashtu siç i thotë zgjedhësi.

(2) Këtë mënyrë të këtillë të votimit këshilli i zgjedhjeve e konstaton në procesverbal për punë të këshillit të zgjedhjeve, ashtu që në secilin procesverbal për punë të këshillit të zgjedhjeve i shënon të dhënat se sa zgjedhës të secilës pakice kombëtare kanë votuar me ndihmën e ndihmësit.

b) Personi i cili nuk është në gjendje të shkojë në qendër të votimit

Neni 22

(1) Zgjedhësi i cili nuk është në gjendje të votojë në qendër të votimit e njohton këshillin e zgjedhjeve më së voni deri në orën 11,00 ditën e votimit, se dëshiron të votojë dhe cilës pakicë kombëtare i takon.

(2) Pasiqë konstaton se një person i tillë është regjistruar në kopjen e Listës së zgjedhësve, kryetari i këshillit të zgjedhjeve i ngarkon tre anëtarë të këshillit të zgjedhjeve që ta zbatojnë votimin jashtë qendrës së votimit.

(3) Komisionerët e këshillit të zgjedhjeve shkojnë te zgjedhësi, e përcaktojnë identitetin e tij dhe e bëjnë verifikimin me llambë UV.

(4) Pastaj komisionerët e këshillit të zgjedhjeve e dorëzojnë zarfin zyrtar në të cilin gjenden: fleta e votimit, lista shumëemërore e zgjedhjeve për anëtarë të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare të cilës i takon zgjedhësi, vërtetimi për të drejtën zgjedhore për votim jashtë qendrës së votimit dhe zarfi në të cilin do të vihet fleta e plotësuar e votimit.

(5) Pas kësaj, komisionerët e këshillit të zgjedhjeve me spraj të veçantë e shënojnë/timbrosin gishtin e zgjedhësit, sipas mënyrës së përcaktuar me nenin 18 të këtyre rregullave.

(6) Pasiqë e njohtojnë zgjedhësin me mënyrën e votimit, komisionerët e këshillit të zgjedhjeve e braktisin ambientin hapësinor në të cilin ka votuar zgjedhësi.

(7) Pasiqë voton, zgjedhësi e nënshkruan vërtetimin për të drejtën e vetë zgjedhore.

(8) Pastaj e vë fletën e votimit të plotësuar dhe të palosur në zarf të cilin komisionerët e këshillit të zgjedhjeve para tij e vulosin me dyllin e vulosjes.

(9) Kështu zarfin e vulosur zgjedhësi e vë bashkë me vërtetimin e nëshkruar për të drejtën e vet të votimit në zarf zyrtar të cilin pastaj komisionerët para tij e vulosin në dyllin e vulosjes.

(10) Menjëherë pas kthimit në qendër të votimit, komisionerët e këshillit të zgjedhjeve ia dorëzojnë zarfin zyrtar kryetarit të këshillit të zgjedhjeve, i cili e hap zarfin zyrtar në të cilën gjendet vërtetimi për të drejtën zgjedhore dhe, nëse vërtetimi është i nënshkruar, e rrumbullakëson numrin rendor nën të cilin zgjedhësi është regjistruar në kopje në listën e zgjedhësve.

(11) Nëse vërtetimi për të drejtën zgjedhore nuk është nënshkruar, konsiderohet që zgjedhësi nuk ka votuar, gjë që shënohet në proceverbale për punën e këshillit të zgjedhjeve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare të cilës i takon zgjedhësi.

(12) Pastaj kryetari i këshillit të zgjedhjeve e hap zarfin e vulosur dhe nga ai e nxjerr fletëvotimin e palosur dhe e hedh në kuti të votimit.

(13) Këshilli i zgjedhjeve e shënon në procesverbal për punën e këshillit të zgjedhjeve të pakicës së caktuar kombëtare të dhënë se sa zgjedhës të pakicës kombëtare kanë votuar jashtë qendrës së votimit, kurse në material tjetër zgjedhor në zarf të veçantë i bashkëngjet edhe të gjitha vërtetimet e nënshkuara për të drejtën zgjedhore.

(14) Nëse zgjedhësi i cili voton jashtë qendrës së votimit nuk është në gjendje ta plotësojë fletën e votimit (personi i verbër invalidi ose personi që nuk di shkrim-lexim), ai mund të votojë me ndihmën e ndihmësit të cilin e cakton vetë, në të njëjtën mënyrë të cilën e përdorin këtë ndihmë personat e verbër, invalidët ose personat që nuk dinë shkrim-lexim të cilët votojnë në qendër të votimit.

(15) Votimi i zgjedhësve jashtë qendrës së votimit mund të bëhet vetëm në zonën e qendrës së votimit.

VII. MBAJTJA E RENDIT NË QENDËR TË VOTIMIT

Neni 23

(1) Ndalohet ndalja në qendër të votimit e të të gjithë personave të cilët nuk kanë të drejta dhe detyra lidhur me zbatimin e zgjedhjeve.

(2) Në qendër të votimit ndalohet përdorimi i celularëve dhe i mjeteve të tjera të ndërlidhjes dhe të komunikacionit, si edhe i aparatëve fotografikë dhe kamerave.

(3) Në qendër të votimi ndalohet që, jashtë evidencës zyrtare në kopje në listën e zgjedhësve, të bëhen listat e zgjedhësve të cilët kanë dalë në votim (shënimi i emrave ose i numrit rendor nga kopja nga lista e zgjedhësve të cilët kanë dalë ose nuk kanë dalë në zgjedhje).

(4) Në raste të jashtëzakonshme, lejohet që anëtarët e këshillit të zgjedhjeve të cilët janë të ngarkuar të merren me kopjet në listën e zgjedhësve, duke i shënuar vizat në letër të veçantë, të mbajnë evidencën për përqindjen e pjesëmarrësve të zgjedhësve dhe që të dhënat për përqindjen e pjesëmarrësve në zgjedhje t'ua kumtojnë të gjithë anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve.

(5) Shkelja e ndalimeve nga paragrafët 1,2, dhe 3, të këtij neni konsiderohet prishje e rendit në qendër të votimit.

Neni 24

(1) Përfaqësuesit e mjeteve të informimit mund të jenë të pranishëm në qendër të votimit vetëm për përgatitjen e raportit për rrjedhën e votimit në qendër të votimit.

(2) Gjatë tërë kohës nga hapja deri te mbyllja e qendrës së votimit, këshilli i zgjedhjeve e njohton Komisionin Republikan të Zgjedhjeve për rrjedhën e votimit sipas mënyrës e cila do të përcaktohet me vendim të veçantë të Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.

Neni 25

(1) Këshilli i zgjedhjeve ka për detyrë të mbajë rendin në qendër të votimit.

(2) Nëse në qendër të votimit prishet rendi, këshilli i zgjedhjeve mund ta ndërprejë votimin derisa nuk vendoset rendi. Shkaqet për ndërprerjen e votimit dhe kohëzgjatja e ndërprerjes së votimit shënohen në procesverbal për punën e këshillit të zgjedhjeve.

(3) Nëse ndërprerja e votimit ka zgjatur më gjatë se një orë, votimi zgjatet për aq kohë sa ka zgjatur ndërprerja.

VIII. POZITA E PËRFAQËSUESVE TË PROPOZUESVE TË LISTAVE TË KANDIDATËVE DHE VËZHGUESVE

Neni 26

(1) Personit i cili gjendet në listë të përfaqësuesve të autorizuar të propozuesve të listës së kandidatëve e dorëzuar këshillit të zgjedhjeve nga ana e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve, këshilli i zgjedhjeve ka për detyrë t'ia mundësojë që pa u penguar të mbikëqyrë punën e këshillit të zgjedhjeve në të gjitha fazat e punës së tij, duke filluar nga përgatitja për hapjen e qendrës së votimit deri te konstatimi i rezultateve të votimit.

(2) Këshilli i zgjedhjeve ka për detyrë që vëzhguesve të cilëve Komisioni Republikan i Zgjedhjeve ua ka lejuar përcjelljen e zgjedhjeve dhe ua ka lëshuar akreditimet, t'ua mundësojë përcjelljen e papenguar të secilit veprimi në zgjedhje.

Neni 27

(1) Këshilli i zgjedhjeve ka për detyrë që në procesverbal për punën e këshillit të zgjedhjeve t'i shënojë të dhënat për përfaqësuesit e pranishëm të propozuesve të listave të kandidatëve dhe të vëzhguesve.

(2) Këshilli i zgjedhjeve mundet që nga qendra e votimit ta largojë përfaqësuesin e propozuesit të listës së kandidatëve ose vëzhguesin nëse nuk u përmbahen rregullave për mbajtjen e rendit në qendër të votimit, nëse në qendër të votimit e përdorin celularin ose mjete tjera të ndërlidhjes dhe të komunikimit, e veçanërisht në çfarëdo mënyre përzihen në punë të këshillit të zgjedhjeve.

(3) Këshilli i zgjedhjeve ka për detyrë që për largimin e përfaqësuesve të propozuesve të listës së kandidatëve ose të vëzhguesit dhe për shkaqet e largimit menjëherë ta njohtojë organin punues dhe Komisionin Republikan të Zgjedhjeve.

IX. MBYLLJA E QENDRËS SË VOTIMIT

Neni 28

(1) Qendra e votimit mbyllet në orën 20,00.

(2) Zgjedhësve të cilët janë gjetur në qendër të votimit me rastin e mbylljes së qendrës së votimit, u mundësohet të votojnë.

(3) Si zgjedhës i cili është gjetur në qendër të votimit konsiderohet zgjedhësi i cili në orën 20,00 gjendet në qendër të votimi ose pak përpara.

(4) Zgjedhësit të cilët gjenden në qendër të votimit këshilli i zgjedhjeve i njohton që mund të votojnë.

(5) Kryetari i këshillit të zgjedhjeve ka për detyrë të caktojë anëtarin ose zëvendësin e anëtarit të këshillit të zgjedhjeve i cili do ta konstatojë numrin e zgjedhësve të cilët janë gjetur në qendër të votimit, të përcaktojë renditjen sipas së cilës ata votojnë, të ndalet pas zgjedhësit të fundit i cili është gjetur për të shënuar fundin e rreshtit dhe pret që të votojnë të gjithë ata të cilët janë gjetur në qendër të votimit.

X. KONSTATIMI I REZULTATEVE TË VOTIMIT

Neni 29

(1) Pas mbylljes së qendrës së votimit këshilli i zgjedhjeve i konstaton rezultatet e votimit në qendër të votimit.

(2) Në konstatimin e rezultateve të votimit duhet të marrin pjesë të gjithë anëtarët e këshillit të zgjedhjeve ose zëvendësit e tyre.

a) Procedura e konstatimit të rezultateve të zgjedhjeve

Neni 30

(1) Procedura e konstatimit të rezultateve të votimit zbatohet veçanërisht për secilin këshill kombëtar i cili zgjedhet në këtë qendër të votimit, me ç'rast së pari konstatohen rezultatet e votimit në zgjedhje për anëtarë të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare me numër më të madh të zgjedhësve të regjistruar në kopjen në listën e zgjedhësve, kurse të fundit përcaktohen rezultatet e votimit në zgjedhjet për anëtarë të këshillit kombëtar të pakicës me numër më të vogël të zgjedhësve të regjistruar në kopjen në listën e zgjedhësve.

(2) Rezultatet e votimit për zgjedhjen e secilit këshill kombëtar veçanërisht konstatohen në këtë mënyrë:

1) numërohen fletëvotimet e papërdorura dhe vihen në zarf të veçantë i cili vuloset kurse numri i tyre shënohet në rubrikën 15 të procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve;

2) numërohet numri i zgjedhësve të cilët janë regjistruar në kopjen në listën e zgjedhësve dhe në kopje të veçantë të listës së zgjedhësve sipas së cilës kanë votuar zgjedhësit të cilët janë në shërbim ushtarak, stërvitje ushtarake ose në shkollim në njësi ose institucione të Ushtrisë së Serbisë, nëse është caktuar që të

votojnë në këtë qendër të votimit, dhe kështu konstatohet numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar, i cili shënohet në rubrikën 16 të procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve;

3) numërohen zgjedhësit të cilët janë rrumbullakësuar në kopjen në listën e zgjedhësve të pakicës kombëtare dhe kështu konstatohet numri i zgjedhësve të cilët kanë votuar dhe ky numër shënohet në rubrikën 17 të procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve;

4) hapet kutia e votimit dhe vërtetohet a gjendet në të lista e kontrollit për vërtetimin e rregullsisë së kutisë së votimit dhe rezultati i vërtetimit konstatohet në procesverbal për punën e këshillit të zgjedhjeve (rubrika 11 alinea e tretë e procesverbalit). Lista e kontrollit vihet në zarf të veçantë i cili vulloset;

5) fletët e votimit ndahen dhe klasifikohen sipas shenjave të pakicave kombëtare këshillat kombëtare të të cilave zgjedhen në këtë qendër të votimit;

6) numërohen fletat e votimit të pakicave kombëtare për të cilat konstatohet rezultati i votimit, që janë gjetur në kutinë e votimit dhe ky numër shënohet në rubrikën 18, të procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve;

7) fletët e votimit nga pika e mëparshme klasifikohen në të vlefshme dhe të pavlefshme;

8) numërohen fletët e pavlefshme të votimit, vihen në një zarf të veçantë i cili vulloset me vulë, dhe ky numër shënohet në rubrikën 18.1. të procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve;

9) numërohen fletëvotimet e vlefshme, dhe ky numër shënohet në rubrikën 18.2. të procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve;

10) fletëvotimet e vlefshme klasifikohen sipas listave të kandidatëve, përcaktohet numri i votave që i është dhënë secilës liste, i cili shënohet në rubrikën 19, të procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve;

11) të gjitha fletëvotimet e vlefshme vihen në zarf të veçantë i cili vulloset.

(3) Procedura nga paragrafi 2 i këtij neni, me përjashtim të veprimeve nga pikat 4) dhe 5), përsëritet për konstatimin e rezultatit të votimit në zgjedhjet për anëtarë të këshillit kombëtar të pakicës kombëtare me numër më të madh të ardhshëm të zgjedhësve të regjistruar në kopjen në listën e zgjedhësve dhe kështu me radhë derisa nuk konstatohen rezultatet e votimit në zgjedhje për anëtarë të të gjitha këshillave kombëtare të cilat zgjedhen në këtë qendër të votimit.

b) Dallimi i fletës së vlefshme dhe të pavlefshme të votimit

Neni 31

(1) Fletëvotim i pavlefshëm është fletëvotimi i paplotësuar, si edhe fletëvotimi i cili nuk është plotësuar ashtu që nuk mund të konstatohet për cilën listë të kandidatëve ka votuar zgjedhësi, për shembull:

1) fletëvotimi në të cilin zgjedhësi e ka rrumbullakësuar ose e ka nënvizuar më shumë se një numër rendor para emërimit të listave të kandidatëve;

2) fletëvotimin në të cilin zgjedhësi e ka rrumbullakësuar ose i ka nënvizuar më shumë se një listë të kandidatëve;

3) fletëvotimi në të cilin zgjedhësi e ka rrumbullakësuar ose i ka tërhequr më shumë se një mbajtës të listës së kandidatëve.

(2) Fletëvotimi i vlefshëm është ai në të cilin është rrethuar një numër rendor para emërimit të listës së kandidatëve, si edhe fletëvotimi i cili është plotësuar sipas mënyrës nga e cila me siguri mund të përfundohet për kë ka votuar zgjedhësi, për shembull:

1) nëse në fletën e votimit zgjedhësi e ka rrumbullakësuar ose e ka nënvizuar emrin dhe mbiemrin e kandidatit të parë në listën e kandidatëve;

2) nëse në fletëvotim zgjedhësi e ka rrumbullakësuar ose e ka nënvizuar emërtimin ose një pjesë të emërimit të një liste të kandidatëve;

3) nëse në fletëvotim zgjedhësi njëkohësisht e ka rrumbullakësuar ose e ka nënvizur numrin rendor dhe emërtimin e listës së kandidatëve dhe emrin dhe mbiemrin e kandidatit të parë në këtë listë të kandidatëve;

4) nëse në fletëvotim zgjedhësi e ka rrumbullakësuar ose e ka nënvizuar emrin e njërit prej bartësve të listës së kandidatëve;

5) nëse në fletëvotim zgjedhësi njëkohësisht e ka rrumbullakësuar ose e ka nënvizuar emrin dhe mbiemrin e kandidatit të parë në listën e kandidatëve dhe emrin e bartësit të kësaj liste të kandidatëve.

(3) Nëse fletëvotimi është plotësuar sipas mënyrës nga e cila mund të pohohet me siguri për cilën listë të zgjedhësve ka votuar zgjedhësi, ai do të jetë i vlefshëm edhe përkundër asaj që:

- në fletëvotim janë shkruar ose janë vizatuar komente, parulla dhe mesazhe të tjera;

- që listave të tjera të zgjedhësve u është hequr vizë.

c) Plotësimi i procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve

Neni 32

(1) Sapo që konstatohen rezultatet e votimit për zgjedhjen e kandidatëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare, këshilli i zgjedhjeve e plotëson qartë, procesverbalin për punën e këshillit të zgjedhjeve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të kësaj pakice kombëtare.

(2) Në Procesverbal për punën e këshillit të zgjedhjeve, ndër të tjera, shënohet: data dhe vendi i votimit; numri dhe emërtimi i qendrës së votimit; emri dhe mbiemri i anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve; numri i fletëvotimeve të pranuar për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare; numri i fletëvotimeve të papërdorura për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare; numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në kopjen në listën e zgjedhësve të një pakice të caktuar kombëtare (në të cilën hyjnë edhe zgjedhësit të cilët janë regjistruar në listë të veçantë në listën e zgjedhësve për votimin e votuesve në shërbim ushtarak, në stërvitje ose në shkollim në njësitë ose institucionet e Ushtrisë së Serbisë); numri i zgjedhësve i një pakice kombëtare të cilët kanë votuar; numri i zgjedhësve i një pakice kombëtare të cilët kanë votuar me ndihmën e personit tjetër; numri i zgjedhësve i një pakice të caktuar kombëtare të cilët kanë votuar jashtë qendrës së votimit; numri i fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare; numri i fletëvotimeve të vlefshme për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare; numri i votave të dhëna për secilën listë të kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare.

(3) Në procesverbal për punë të këshillit të zgjedhjeve shënohen edhe vërejtjet dhe mendimet e anëtarëve, zëvendësve të anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve dhe përfaqësuesve të listave të kandidatëve.

(4) Nëse procesverbalin për punë të këshillit të zgjedhjeve nuk e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e këshillit të këshillit të zgjedhjeve, kjo konstatohet në procesverbal për punën e këshillit të zgjedhjeve dhe me këtë eventualisht pohohen edhe shkaqet për shkak të të cilave nuk është nënshkruar procesverbali.

Neni 33

- (1) Procesverbalet për punën e këshillit të zgjedhjeve hartohen në formularë të përcaktuar për secilën pakicë kombëtare veçanërisht, të cilët shtypen në gjashtë ekzemplarë.
- (2) Ekzemplari i parë i secilit procesverbali për punë të këshillit të zgjedhjeve i dërgohet organit të punës së Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.
- (3) Ekzemplari i dytë i procesverbalit theksohet në qendër të votimit për këqyrje publike.
- (4) Katër ekzemplarë të tjerë të procesverbalit u dërgohen përfaqësuesve të propozuesve të listave të kandidatëve të cilët e kanë fituar numrin më të madh të votave për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakcie të caktuar kombëtare në atë qendër të votimit, nëse propozuesi i listës së kandidatëve e ka përfaqësuesin në qendër të votimit.

XI. KONTROLLI LOGJIK DHE LLOGARITËS I PROCESVERBALIT PËR PUNËN E KËSHILLIT TË ZGJEDHJEVE

Neni 34

Kontrolli logjik-llogaritës i procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve e përfshin: radhitjen llogaritëse të të dhënave për zgjedhës, radhitjen llogaritëse të të dhënave për zgjedhës dhe për fletët e votimit dhe radhitjen llogaritëse të të dhënave për fletëvotimet dhe votat.

a) Radhitja llogaritëse e të të dhënave për zgjedhës

Neni 35

- (1) Numri i përgjithshëm i zgjedhësve i një pakice të caktuar kombëtare të cilët kanë votuar (rubrika 17 e procesverbalit) është i barabartë me numrin e zgjedhësve të cilët janë rumbullakësuar në kopjen në listën e zgjedhësve të kësaj pakice kombëtare.
- (2) Numri i përgjithshëm i zgjedhësve i një pakice kombëtare të caktuar të cilët kanë votuar (rubrika 17 e procesverbalit) mund të jetë i barabartë ose më i vogël se numri i zgjedhësve të regjistruar në kopjen në listën e zgjedhësve të kësaj pakice kombëtare (rubrika 16 e procesverbalit).

b) Renditja llogaritëse e të të dhënave për zgjedhësit dhe fletët e votimit

Neni 36

(1) Numri i përgjithshëm i fletave të votimit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare që gjenden në kuti të votimit (rubrika 18 e procesverbalit) është i barabartë ose më i vogël se numri i zgjedhësve të kësaj pakice kombëtare të cilët kanë votuar (rubrika 17 e procesverbalit).

(2) Numri i fletëve të votimit të pranuar për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare (rubrika 14 e Procesverbalit) është i barabartë me shumën: numrin e fletëve të votimit të përdorura për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare (rubrika 15 e procesverbalit) dhe numri i zgjedhësve të kësaj pakice kombëtare të cilët kanë votuar (rubrika 17 e procesverbalit).

c) Renditja llogaritëse e të dhënave për fletët e votimit dhe për vota

Neni 37

(1) Numri i fletëve të votimit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare të cilët gjenden në kuti të votimit (rubrika 18 e procesverbalit) është i barabartë me: numri i fletëve të pavlefshme të votimit (rubrika 18.1 e procesverbalit) dhe numrit të fletëve të vlefshme të votimit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare (rubrika 18.2. e procesverbalit).

(2) Numri i fletëve të vlefshme të votimit për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit kombëtar të një pakice të caktuar kombëtare (rubrika 18.2. të procesverbalit) është i barabartë me shumën e numrit të votave të cilat i kanë marrë të gjitha listat e zgjedhësve për anëtarë të këshillit kombëtar për një pakicë të caktuar kombëtare (tabela në rubrikën 19 të procesverbalit).

Neni 38

(1) Koordinatori i Komisionit Republikan të Zgjedhjeve ia dorëzon Komisionit Republikan të Zgjedhjeve raportin për kontrollin e kryer logjik dhe llogaritës për secilën njësi të vetëqeverisjes vendore për qarkun për të cilin është i ngarkuar.

(2) Raporti nga paragrafi 1, i këtij neni veçanërisht përmban të gjitha ndryshimet për procesverbalin për punën e këshillit të zgjedhjeve të bëra pas kontrollit logjik-llogaritës nga ana e kryetarit ose anëtarit,

përkatësisht zëvendësve të tyre të këshillit të zgjedhjeve, të personit të autorizuar të Entit Republikan për Statistikë ose anëtarit, përkatësisht zëvendësit të anëtarit të Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.

XII. DËRGIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR PAS VOTIMIT

Neni 39

(1) Pasiqë i konstaton rezultatet e votimit në qendër të votimit, këshilli i zgjedhjeve menjëherë, e jo më vonë se 12 orë nga ora e mbylljes së qendrës së votimit ia dorëzon organit punues në ndërtesë të komunës/qytetit, këtë material zgjedhor:

1) ekzemplarët e parë të procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve në zbatimin e votimit dhe konstatimin e rezultateve të votimit në zgjedhjet për anëtarë të secilit këshilli kombëtar që janë zgjedhur në qendër të votimit,

2) kopjet nga lista e zgjedhësve dhe kopjet e veçanta nga lista e zgjedhësve sipas të cilave është votuar në qendër të votimit në zgjedhjet për anëtarë të secilit këshilli kombëtar,

3) zarfën e vulosur në të cilin lista e kontrollit për verifikimin e rregullsisë së kutisë së votimit,

4) zarfat e vulosur në të cilat janë hedhur fletë e papërdorura të votimit për votim në zgjedhjet për anëtarë të secilit këshilli kombëtar i cili është zgjedhur në qendër të votimit veçanërisht,

5) zarfat e vulosur në të cilët janë hedhur fletëvotimet e pavlefshme për votim në zgjedhjet për anëtarë të secilit këshilli kombëtar i cili është zgjedhur në qendër të votimit veçanërisht,

6) zarfat e vulosur në të cilat janë vendosur fletëvotimet e vlefshme për votim për zgjedhjet për anëtarë të secilit këshilli kombëtar i cili është zgjedhur në qendër të votimit veçanërisht,

7) zarfat e vulosur në të cilët janë vendosur vërtetimet e nënshkruara për të drejtën zgjedhore për votim jashtë qendrës së votimit në zgjedhje për anëtarë të secilit këshilli kombëtar veçanërisht,

8) materiali tjetër zgjedhor.

(2) Kopjet në listën e veçantë e zgjedhjeve, ekzemplarët e parë të procesverbalit për punën e këshillit të zgjedhjeve dhe zarfat e vulosur me vërtetime të nënshkruara për të drejtën zgjedhore jashtë qendrës së votimit, këshilli i zgjedhjeve i dorëzon veçmas nga materiali tjetër zgjedhor, i cili paketohet në thes për depozitim të materialit zgjedhor dhe kështu i dorëzohet organit të punës.

(3) Me rastin e dorëzimit të materialit zgjedhor, këshilli i zgjedhjeve rreptësisht do të ketë kujdes që të mos e përziejë materialin zgjedhor për zbatimin e zgjedhjeve për anëtarë të këshillave kombëtare të pakicave të ndryshme kombëtare.

(4) Materiali i mbetur (kuta e votimit, ndarëset për votim, llambat UV, pajisja për të shkruar dhe etj.) këshilli i zgjedhjeve ia dorëzon administratës komunale/të qytetit.

(5) Për marrjen në dorëzim të materialit hartohet procesverbali në formular të përcaktuar.

(6) Pas votimit në Institucion për ekzekutimin e sanksioneve të institucionit, këshilli i zgjedhjeve, menjëherë, materialin përkatës të zgjedhjeve nga paragrafi 1 i këtij neni ia dorëzon organit punues në ndërtesë të komunës/qytetit.

Neni 40

Me rastin e dorëzimit të materialit zgjedhor, kryetari i këshillit të zgjedhjeve ka për detyrë që administratës së komunës/qytetit t'ia dorëzojë evidencën për praninë e anëtarëve dhe zëvendësve të anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve në qendër të votimit.

XIII. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 41

Këto rregulla hyjnë në fuqi ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Republikës së Serbisë".

02 Numër: 013-962/14

Në Beograd, më 8 shtator të vitit 2014.

KOMISIONI REPUBLIKAN I ZGJEDHJEVE

ZËVENDËS I KRYETARIT

Ivan Shebek